



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1629/8 prot.

Datë 04 /08/2025

V E N D I M
Nr. 1006 /2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04 /08/2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.861 /2025, datë 08 .07.2025 dhe nr. 866/2025 datë 08.07.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr.REF-51751-06-19-2025, me objekt: “Blerje paisje kompjuterike, fotokopje dhe printera për vitin 2025”, me fond limit 3,331,809 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 03.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kolonjë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Blueprint Technologies” sh.p.k, me NIPT L82428011G dhe adresë: Njësia Administrative nr. 10, Rruga “Fortuzi ”, Nr. 66/1.

Operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK me Nipt K71903025A dhe adresë: Rruga “Shyqyri Berxolli”, Pallati Inter Co-Sat, Seksioni B, Kati i 6-te, Nr. 6/5, Dera 28B, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kolonjë
Sheshi “Rilindja”, Kolonjë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të

Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 08.07.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.861/2025, datë 08.07.2025, ku vendosi:

- 1. [...]Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr.REF-51751-06-19-2025, me objekt: “Blerje paisje kompjuterike, fotokopje dhe printera për vitin 2025”, me fond limit 3,331,809 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 03.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kolonjë.*
- 2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*
- 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK.*
- 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Në datë 08.07.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.866/2025, datë 08.07.2025, ku Vendosi:

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-51751-06-19-2025, me objekt “Blerje paisje kompjuterike,*

fotokopje dhe printera për vitin 2025”, me fond limit 3,331,809.00 lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 03-07-2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kolonjë.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 3530 prot., datë 15.07.2025, protokolluar me tonën nr. 1671/6 prot., datë 01.08.2025 autoriteti kontraktor Bashkia Kolonjë , njofton mbi ndryshimin dokumentave të tenderit për procedurën e sipërmendur, duke e modifikuar kriteret e pretenduara nga operatori ekonomik “Blueprint technologies” shpk, dhe operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK në procedurën e prokurimit me REF-51751-06-19-2025, me objekt “Blerje paisje kompjuterike, fotokopje dhe printera për vitin 2025”, me fond limit 3,331,809.00 lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 03-07-2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kolonjë.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 3530 prot., datë 15.07.2025, protokolluar me tonën nr. 1671/6 prot., datë 01.08.2025 autoriteti kontraktor Bashkia Kolonjë , njofton mbi ndryshimin dokumentave të tenderit për procedurën e sipërmendur, duke e modifikuar kriteret e pretenduara nga operatori ekonomik “Blueprint technologies” shpk, dhe operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK në procedurën e prokurimit me REF-51751-06-19-2025, me objekt “Blerje paisje kompjuterike, fotokopje dhe printera për vitin 2025”, me fond limit 3,331,809.00 lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 03-07-2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kolonjë.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionit bashkëlidhur saj, si dhe verifikimeve të publikimeve në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se autoriteti kontraktor nuk ka kryer modifikimet për procedurën e prokurimit të sipërmendur sipas përcaktimeve të Vendimit K.P.P Nr.866/2025, datë 08.07.2025 dhe Vendimit K.P.P Nr. 861/2025, datë 08.07.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Referuar pretendimit të operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, të paraqitur nëpërmjet ankesës me nr. 1671/2025 prot., datë 25.06.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5476, datë 26.06.2025, ku ka kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt – ankimi, konkretisht: *“2- Ne piken 2.2.2 të shtojcës 8 kërkohej: 2.2.2 Operatori/et ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022-2023-2024, të certifikuara nga autoritetet përkatëse, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuara, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kërkesa e mesipërme nuk është në përputhje me LPP dhe aktet nënligjore në mbështetje të tij. Procedura objekt ankimi është procedura E hapur e Thjeshtuar. Për këtë procedurë, LPP dhe VKM për RPP parashikon se Kriteret ekonomike financiare duhet të jenë të thjeshtuara, dhe këto të fundit provohen me paraqitjen e vertetimit të xhiros për 3 vitet e fundit. (neni 55 pika 4 I VKM 285 datë 19.05.2021)”* Komisioni ka argumentuar si në vijim... Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e ekonomike të nevojshme për realizimin e kontratës. Në këtë kuadër KPP, vëren se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit krahas paraqitjes së bilanceve nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm, gjithashtu të jenë, të certifikuara nga autoritetet përkatëse, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. Sa më sipër, referuar llojit të procedurës së prokurimit e konkretisht “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, legjislacioni parashikon që autoritet/entet kontraktore duhet të përcaktojnë kriteret të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në frymën e ligjit, duhet të marrë masa për të hequr kriterin e kërkesës së dorëzimit të kopjeve të bilanceve të certifikuara, që plotësimi i këtyre kërkesave të mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë.

II.4. Komisioni Prokurimit Publik duke marrë shkasë nga përmbajtja e shkresës Nr. 3530 prot., datë 15.07.2025, protokolluar me tonën nr. 1671/6 prot., datë 01.08.2025 të autoritetit kontraktor Bashkia Kolonjë, gjykon se në përmbushje të pikës III.2.5 të vendimit Nr. 866/2025, datë 08.07.2025 autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin sipas përcaktimeve të vendimit të sipërmendur, dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e kësaj pike.

II.5. Sa më sipër, autoriteti kontraktor, Bashkia Kolonjë, nuk ka zbatuar vendimin Nr. 866/2025, datë 08.07/2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, konkretisht pikën III.2.5 të tij për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr.REF-51751-06-19-2025, me objekt: “Blerje paisje kompjuterike, fotokopje dhe printera për vitin 2025”, me fond limit 3,331,809 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 03.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kolonjë.
 2. Autoriteti kontraktor të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik dhe të publikojë në SPE shtojcën me ndryshimet e dokumentave të tenderit, në zbatim të vendimit Nr. 866/2025, datë 08.07/2025 të Komisionit të Prokurimit Publik.
 3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

